



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0488

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori kyetare duke vendosur sipas ankesës së OE “CAPITAL X FET” SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve Komunale” me numër të prokurimit 613-25-2516-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN”, më 21/08/2025, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e “CAPITAL X FET” SH.P.K. me nr. 2025/0488, e datës 13/06/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve Komunale”, me numër të prokurimit 613-25-2516-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN”.

2. Mbetet në fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN” për aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve Komunale”, me numër të prokurimit 613-25-2516-2-1-1.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 27.03.2025, “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve Komunale” me numër të prokurimit 613-25-2516-2-1-1, ndërsa me datën 30.05.2025 Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues B58 për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 160,000.00 €.

Me 02.06.2025, OE "CAPITAL X FET" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 03.06.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 13/06/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga "CAPITAL X FET" SH.P.K. me nr. 2025/0488 lidhur me aktivitetin "Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve Komunale" me numër të prokurimit 613-25-2516-2-1-1

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: Përgjigje në pretendimin ankimor 1- Qasaj, Autoriteti Kontraktues Komuna e Lipjanit është përgjigjur brenda 3 ore, duke futur edhe orën e pauzës, kërkesa për qasje ka ardhur në e-mail në ora : 9:55, e hëne, të datës 02.06.2025, përgjigjur në kërkesën për qasje në dokumentacion nuk është e vërtetë sepse siç shihet në sistem është vetëm kërkesa për ri-shqyrtim dhe asnjë kërkesë tjetër, andaj përgjigjeja në e-mail i është kthyer OE në ora 14:11, ndërsa kërkesa për Rishqyrtim është paraqitur me një herë pas pauzës në ora 13:31, pa siq shifet OE në fjalë kapasur kohe edhe me pranuar qasje edhe me dorëzua kërkesën për Rishqyrtim pasi që afati për paraqitjen e kërkesës për Rishqyrtim 04.06.2025, ora 16:00, pra siq po shifet OE ka qene shumë tendencioz me AK, shif shkresat dhe komunikimet elektronike.

Sa i përket pretendimit të dytë se e keni pranuar kërkesën për plotësim të dokumentacionit me vonëse edhe kjo nuk qëndron se është një fakt që vërtetohet shumë lehtë. Letra standarde për plotësim të dokumentacionit te ju ka mbërritur më datë 20.05.2025, pra jeni i pa përgjegjshëm nuk jeni përgjigjur deri më datë: 28.05.2025 që dmth i tejkaloni afatin e paraparë për dorëzim të dokumentacionit të kërkuar.

Bazuar ne LPP neni 1 dhe 7, gjithashtu ne Rregulloren e Prokurimit Publik, trajtim i barabartë për të gjithë OE.

Nuk kemi qka sqarojmë më shumë këtu pasi që tregon sistemi i E-Prokurimit, gjithashtu ju OE e dini dhe e njiheni shume mirë këtë sistem.

Shiko faktet:AK, konsideron se tenderi juaj është vlerësuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "CAPITAL X FET" SH.P.K. janë parashtruar si në vijim: Letrën standarde për tenderues të eliminuar e kemi pranuar permes platformës elektronike,më pas me daten 02.06.2025 kemi kerkuar qasje ne dokumentacion ne ora 09:54 ne email te Zyrtarit te Prokurim Bekim Shabani (Email bekim.g.shabani@rks- gov.net) ndersa ne ora 14:45 pas parashtrimi te kerkeses per rishqyrtim nga ana jone , permes emailit zt.Bekim Arifaj na lejon qasje ne dokumentacion duke aluduar se ka pranuar nga ne vetem kerkese per rishqyrtim gjc qe bie ndesh sepse ne kemi kerkuar qasje ne dokumentacion ne emailin zyrtar qe cshte pjese edhe Formularit te Dosjes se

Tenderit, por deri ne momentin e parashtrimit te Kerkeses per Rishyrtim nuk na eshte lejuar Qasja. Lidhur me Letren Standarde mbi Eliminim , ku Autoritet Kontraktues na ka eliminuar me pretendimin se nuk jemi pergjigjur ne nje Kerkese per Sqarime lidhur me Listen e Paisjeve , ne e-mail neve si OE nuk na ka ardhur njoftimi ,nga qe ne dokumentin e pranur nga AK ne platforme elektronike e-prokurimi jane datat e njejta por me ore te ndryshme njera eshte 20.05.2025 11:51 ndersa tjetra eshte 20.05.2025 14:10 (qe mund te verifikohet ne platforme e-prokurimi) ,per kete apo ndonje arsye tjere neve nuk na ka ardhur njoftimi ku me gjase kjo le te nenkuptohet se ka qene nje “e mete” e vete sistemit.

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te LPP ku nuk ka nderrmarc masa tjera per njoftim neve si OE per Sqarimet qe i ka kerkuar , permese e-mail adreses , telefonit apo edhe fizikisht, pavaresisht kesaj ne me daten 28.05.2025 ne nje kontrole ne sistemin elektronike te e-prokurimit e kemi pare qe na ka ardhur nje Kerkese per Sqarime dhe menjehere e kemi dorzuar Listen e Pajisjeve siq eshte kerkuar nga AK, ne anen tjere AK edhe pas pranimit te dokumentacionit te Kerkuar me daten 30.05.2025 nuk e merr parasyshe dokumentet e derguar dhe merr Vendim per Anulimi te Tenderit edhe pse jemi te vetmit OE te pergjegjshem ne kete procedure te prokurimit, ku edhe ne baze te Vendimit te leshuar OE ekonomik E-Commerce eshte shpallur i pa pergjegjshem administrativisht nga qe nuk e ka plotesuar Analizen Financiare siq kerohen ne FDT si dhe Haris Karameta BI po ashtu i pa pergjegjshem administrativisht nga qe nuk ka plotesuar kriterin e projekteve te perfimduar ne 3 vitet e fundit. Duke qene se kemi qene OE i pergjegjshem me cmimi me te ulet dhe nuk kemi tejkualuar vleren e kontrates , AK eshte dasht ti shfrytezoi gjitha hapsirat ligjore te komunikoj me ne , lidhur per Sqarimet e kerkuar ose ti pranoje dokumentet e pranuar me daten 28.05.2025 dhe te na shpalle fitues si OE i pergjegjshem me cmimin me te lire , dhe jo te anulohet procedura e prokurimit edhe pas pranimit te Sqarimeve nga ana jone

Ne i kemi ofruar pergjigje ndaj letres standarde te kerkeses per sqarim me date 28.05.2025 ndersa AK me date 30.05.2025 publikon njoftim per anulimit te procedures ne vend qe te zgjatet afati i pranimit te pergjigjes ndaj kerkeses per sqarime shpese , AK ne menyre te njehshme tenton ne cdo forme te na eliminoje nga ky aktivitet prokurimi dhe pergjigja jone nuk eshte marre fare parasyshe ani pse ne platformen e-prokurimi figuron se AK e ka shkarkuar pergjigjen tone (qe mund te verifikohet ne e-prokurim)

AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 62 (pika 2.1) me anulimin e aktiviteti te prokurimit ku oferta e dorzuar nga ana jone eshte oferta e pergjegjshme me cmimin me te ulet te ofruar perveq se nuk i ka shfrytezuar te gjitha hapsirat ligjore sic parashihen ne LPP (neni 72 pika 1)

AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 te LPP 9 pika 4 citojme : “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”

Pra duke marre parasysh se ne kemi ofruar te gjitha pajisjet e kerkuara ne FTD dhe ato te renditura dhe me deshmi sipas kerkeses AK, AK eshte dashur te veproje konform neni 59 pasi qe mungesa e listes

paraqet devijim te vogel dhe nuk shkakton ndryshimet materiale ne perputhje me LPP .

Edhe pse ka munguar lista e pajisjeve AK ka mundur te shfrytetoje hapesirat ligjore qe te komunikojc me ne,ku ne si OE jcmi duke ekzekutuar kontraten per sherbime te pastrimit dhe mirembajtjes te hapesirave te komunes dhe institucioneve tjera ne Lipjan kontrate e lidhur ne vitin 2022 me afat 36 muaj dhe duke qenc se ne kemi qene me prezence fizike ne AK, AK ka pasur mundesi edhe fizikisht te na dorezoje kerkesen per sqarime dhe jo qellimisht te na neglizhoj dhe anashkaloj me kushtin qc gjithsesi te anulohet procedura e prokurimit kur dihet edhe ndjeshmeria e ketij aktiviteti qe ka te beje me mirembajtje dhe pastrim te hapesirave te brendshme ku secili Autoritet e ka obligative kete sherbim ta kryeje cdo dite

AK ka vepruar ne kundershtim me nenin 108/A (Zgjidhja preliminare c mosmarrëveshjeve) pika 3.3 citojme : 3.3 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti I prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.

AK ka pranuar kerkese per rishyrtim nga OE Haris Karameta BI me date 10.06.2025 , 11 dite pas vendimit te nga AK ku kjo kerkese eshte dashur te mos merret fare ne shqyrtim dhe te refuzohet si e jashte afatshme , ndersa AK me date 11.06.2025 e trajton kete kerkese per rishqyrtim dhe njekohesisht i legjitimon afatin 10 ditor per te paraqitur ankese prane OSHP pcr OE Haris Karameta BI dhe te jete “pale mc interes” pas procedurave te ankimimit. Kerkojme nga OSHP qe ankesen c Haris Karameta BI te mos e shqyrtoje fare dhe te marre masa ndaj Zyrtarit te Prokurimit i cili ka vepruar ne kundershtim me LPP neni 108A.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 1 i LPP-së (Qëllimi), Neni 7 i LPP-së (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi), Neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve), Neni 60 i LPP-së-(Kriteret për Dhënicen e Kontratës), Neni 62 i LPP-së (Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit), Neni 72 i LPP-se (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë), Neni 108/A i LPP-së (Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve). Kerkojme nga OSHP : Te anulohet Vendimi per Anulim i dates 30.05.2025 Lenda te kthehet ne Rivlersim Te shperblehemi me kontrate si OE i pergjegjshem me cmimin me te ulet te ofruar

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues me datë 23.06.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0488/25, ndërsa me datë 28.06.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0488 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK pajtohet me raportin e ekspertizës ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit te ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertës, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertës, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “CAPITAL X FET” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0488 ka vlerësuar si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR. 1 DHE 2- OE “CAPITAL X FET SH.P.K.” pretendon se Autoriteti Kontraktues – Komuna e Lipjanit (AK), ka shkelur nenet 1 dhe 7 të Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042 (në vazhdim “LPP”).

Sipas LPP-së: Neni 1, përkufizon parimet bazë të LPP, përfshirë përdorimin ekonomik, efikas dhe të drejtë të fondeve publike.

Neni 7, ndalon çdo formë të diskriminimit dhe obligon AK-të që të sigurojnë trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin dhe transparencën gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Eksperti vlerëson se pretendimet e OE ankues nuk janë të bazuara. Gjatë gjithë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues ka trajtuar të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe ka vepruar në përputhje me nenet e sipërcekura. Vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit është nxjerrë në harmoni të plotë me këto dispozita.

Përfundim: Pretendimi i OE është i pabazuar dhe vendimi i AK është në përputhje të plotë me nenin 1 dhe 7 të LPP-së.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR. 3 DHE 6- OE pretendon shkelje të neneve 59 dhe 72 të LPP-së nga ana e AK, duke pohuar se nuk është vlerësuar drejt oferta dhe nuk është lejuar qasja në dokumentacion brenda afatit ligjor.

Neni 59 i LPP-së përcakton se vetëm ofertat që janë në përputhje të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit konsiderohen të përgjegjshme. Përfshirë, mund të pranohen gabime ose paqartësi që nuk e ndryshojnë materialisht ofertën, me kusht që të kuantifikohen dhe të merren parasysh në krahasimin e ofertave.

Neni 72, parashihet procedurat për dokumentacionin dhe informacionin shtesë, përfshirë sqarimet gjatë vlerësimit.

AK kishte kërkuar me dt. 20.05.2025, përmes platformës elektronike të prokurimit, sqarime lidhur me Listën e Pajisjeve, me afat përgjigjeje deri më 26.05.2025. OE e ka dorëzuar këtë dokument më 28.05.2025, jashtë afatit të paraparë.

AK ka vepruar në përputhje me nenin 59 dhe 72 të LPP-së, pasi: Sqarimet janë kërkuar në formë të standardizuar përmes platformës elektronike. OE ka pranuar se e ka dorëzuar listën pas afatit.

AK nuk ka pasur obligim ligjor të dërgojë kërkesën për sqarime në forma alternative si e-mail, telefon apo dorëzim fizik, kur është përdorur platforma zyrtare e e-prokurimit, në përputhje me rregulloren përkatëse dhe nenin 38 të Rregullores së Prokurimit. Qasja në dokumentacionin është lejuar brenda afatit ligjor.

Përfundim: Mosrespektimi i afatit nga ana e OE e bën përgjigjen të papranueshme sipas LPP. Pretendimi është i pabazuar, ndërsa AK ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 59 dhe 72 të LPP-së.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR. 4 DHE 5-OE pretendon shkelje të nenit 60 (Kriteret për dhënien e kontratës) dhe nenit 62 (Përfundimi i aktivitetit të prokurimit).

Neni 60 përkufizon se kontrata i jepet ofertës më të favorshme, për sa kohë ajo është e përgjegjshme dhe brenda buxhetit të përcaktuar.

Neni 62, par. 2.1, lejon anulimin e procedurës nëse të gjitha ofertat e përgjegjshme tejkalojnë buxhetin.

Eksperti vlerëson se pretendimet nuk qëndrojnë, sepse:

OE nuk ka dorëzuar dokumentacionin brenda afatit, ndaj konsiderohet i pa përgjegjshëm.

Përfundim: AK ka vepruar drejt në anulimin e aktivitetit dhe pretendimet janë të pabazuara.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR. 7-OE pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 108/A të LPP-së, duke pranuar një kërkesë për rishqyrtim nga OE Haris Karameta BI pas afatit ligjor 5-ditor.

Sipas nenit 108/A, par. 3.3, kërkesat për rishqyrtim për anulim të aktivitetit duhet të parashtrohen brenda 5 ditëve nga data e publikimit të njoftimit.

Eksperti sqaron se:

Kërkesa për rishqyrtim nga OE Haris Karameta BI është dorëzuar në sistemin e prokurimit me datë 04.06.2025, pra brenda afatit ligjor.

Vetëm publikimi i përgjigjes nga AK është bërë më vonë, me dt. 10.06.2025.

Përfundim: Pretendimi i OE është i pabazuar, pasi kërkesa për rishqyrtim është parashtruar brenda afatit ligjor sipas nenit 108/A të LPP-së.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR I EKSPERTIT- Të gjitha pretendimet e OE “CAPITAL X FET SH.P.K.”, nga pretendimi 1 deri në 7, janë të pabazuara ligjërisht. Autoriteti Kontraktues – Komuna e Lipjanit, ka vepruar në përputhje të plotë me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe me Rregulloren për Prokurim Publik, duke respektuar parimet e barazisë, transparencës, konkurrencës dhe përdorimit efikas të fondeve publike.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të

shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi vendimin e AK-së të aktivitetit të prokurimit të Autoritetit Kontraktues – “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve Komunale” me nr. të prokurimit 613-25-2516-2-1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - CAPITAL X FET SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: